



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:257804
Datë: 29.01.2024
Numri i dokumentit: 05254249

C-IV-13-0800

Ankuesja

J K, Gračanica

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit, Rruga “Dritan Hoxha”, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Diellza Hoxha, me 26 janar 2024 lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET ankesa si e pabazuar**
- II. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRN103-0141 i datës 15 maj 2013, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- III. Nuk caktohen taksa gjyqësore për ankuesen.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 04 qershor 2013, ankuesja dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr. PRN103-0141, të datës 15 maj 2013, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me të cilin ka kërkuar kompensimin për paga të pa paguara, në shumë prej 14,974.25 €, për periudhën 1999 – 2007, nga NSH “Urata” (në likuidim). Ankuesja pohoi se pas ngjarjeve të njohura në Kosovë në qershor të vitit 1999, nuk ishte në gjendje të paraqitej në vendin e saj të punës për arsye sigurie. Po ashtu ankuesja pohoi se nuk ka marrë ndonjë vendim zyrtar nga menaxhmenti i NSH-së, për ndërprerjen e mundshme të marrëdhënies së punës dhe për këtë arsye punësimi i saj në këtë NSH nuk është ndërprerë. Në mbështetje të ankesës dorëzoi vendimin e kundërshtuar të AL-së, si dhe librezën e punës.

Me 28 tetor 2016, e paditura në mbrojtjen e saj të parashtruar kundër ankesës, pohoi se AL ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar drejtë. E paditura pohoi se kërkesa e ankesës është e parashkruar. Më tej, e paditura pohoi se konsideron se pretendimet e paraqitura në ankesë, nuk janë të mbështetura me dëshmi dhe fakte materiale që do të ishin relevante për rastin konkret. E paditura propozoi që ankesa të refuzohet si e pabazuar .

Me 18 nëntor 2016, mbrojtja e të paditurës i është dorëzuara ankueses.

Me 12 dhjetor 2017 ankuesja ka dorëzuar parashtrësën të quajtur ankese me të cilën kërkon që ti njihet e drejta për të përfituar 20% nga shitja e NSH-së, vlerën prej 14,974.25 € në emër të pagave të papaguara.

Ka bashkangjitur :

- kopjen e librezës së punës,
- kopja e letërnjoftimit,
- Kopje të vendimit për pushim vjetor të lëshuar nga Voçar –Gracanicë
- Kopjen e kërkesës parashtruar AL

Me 20 dhjetor 2017 AKP-ja është kundërpërgjigjur, duke qëndruar në atë që ka thënë në mbrojtje e dërguar më parë.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuara), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen

faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Në këtë rast gjykata gjen se nuk është kontestues fakti se ankuesja ka qenë punëtore e NSH në fjalë, por nga shkresat e lëndës gjykata vjen në përfundim se ankuesja nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se NSH-ja i ka mbetur borxh pagat e kërkuara për periudhën për të cilën është ushtruar kërkesa, dëshmi se ka ofruar shërbime pune për periudhën e lartcekur, ankuesja nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me llogaritjen e pagave të kërkuara. Ankuesja ka dështuar që të dorëzojë prova në mbështetje të ankesës së saj edhe pas pranimit të mbrojtjes së të paditurës. Libreza e punës e dorëzuar si provë nga ankuesja, vërteton vetëm faktin e krijimit të marrëdhënies së punës, por nuk e vërteton faktin e vazhdimin të kësaj marrëdhënie punësimit. Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive relevante, pretendimet e ankueses lidhur me të drejtën e saj në kompensim për paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do të mbulojë shpenzimet e veta. Ankuesja e ka bërë pagesën e taksës gjyqësore për ankesën e parashtruar.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Diellza Hoxha
Gjyqtare

C-IV-13-0800

Žalilja

J K, Gračanica

Protiv

Tužena

Kosovska Agencija za Privatizaciju- za DP "Vocar" (u likvidaciji) - Ul. "Dritan Hoxha" br.55, Lakrište Priština.

Posebna komora Vrhovnog suda Kosova za pitanja koja se odnose na Kosovsku agenciju za privatizaciju (Posebna komora), sudija Diellza Hoxha, je dana 26 januar 2024 godine, donela ovu:

P R E S U D U

- 1. Žalba se ODBIJA kao neosnovana**
- 2 POTVRĐUJE se Odluka Organa za likvidaciju, PRN103-0141 od 15 maja 2013 godine, kao pravična i zasnovana na zakonu.**
- 3 Žaliji se ne određuju sudske takse .**

Činjenične i proceduralne okolnosti

Žalilja je 04 juna 2013 godine podnela Posebnoj Komori žalbu na Odluku br. PRN103-0141 od 15 maja 2013 godine, Uprave za likvidaciju- Kosovske Agencije za Privatizaciju, (Organ Likvidacije skr.OL) kojom je zatražila naknadu kompenzacije neisplaćenih plata.u iznosu od 14.974,25 eura za period od 1999 do 2007 od DP "Vočar" (u likvidaciji). Žalilja je tvrdila da nakon poznatih događaja na Kosovu u junu 1999. godine nije mogla da se pojavi na svom radnom mestu iz bezbednosnih razloga. Takođe, u žalbi se tvrdi da rukovodstvo DP-a nije donelo zvaničnu odluku o mogućem raskidu radnog odnosa i iz tog razloga njen radni odnos u ovom DP-u nije prekinut. U prilog žalbe priložila je pobijano rešenje Organa likvidacije i radnu knjižicu.

Dana 28 oktobra 2016 godine, tužena KAP je podnela odbranu u žalbi u kojoj je tvrdila da je OL tačno procenio činjenične okolnosti i pravilno primenio zakonske odredbe. Tužena je tvrdila da je zahtev žalilje zastareo. Tužena je dalje navela da smatra da navodi izneti u žalbi nisu potkrijepljeni dokazima i materijalnim činjenicama koje bi bile relevantne za ovaj slučaj. Tužena a je predložila da se žalba odbije kao neosnovana.

Dana 18. novembra 2016. godine odbrana KAP je predata zalilji .

Dana 12 decembra 2017.godine žalija je podnela podnesak pod nazivom žalba kojim traži da joj se prizna pravo na dobit od 20% od prodaje DP, i iznos od 14.974,25 evra za neisplaćene zarade.

žalilja podnela je :

- Kopiju radne knjižice
- Kopiju lične karte
- Kopiju rešenja o godišnjem odmoru izdato od strane Vočar –Gračanica
- Kopiju zahteva podneto Organu likvidacije OL.

Dana 20 decembra 2017 god. KAP je odgovorila, ostajući pri onome što je iznela u svom odgovoru na žalbu .

Pravno obrazloženje

Žalba se odbija kao neosnovana.

Član 42 tačka 2 Zakona o Specialnoj Komori predviđa da stranka koja tvrdi činjenicu ili događaj ima teret dokazivanja da dokaže istinitost takve tvrdnje ,podnošenjem podnesaka ili iznošenjem materialnih dokaza(dokumentovani fizički i/ili dokazi). Dok tačka 3 predviđada stranka koja zahteva činjenicu ili događaj imaju razumnu priliku da izvedu ili podnesu materialne dokaze u prilog takvoj tvrdnji, ako takva stranka ne uspe da izvede ili dostavi takve dokaze onda se smatra da stranka nije obezbedila teret dokazivanja u vezi takve tvrdnje.

Prem članu 7 Zakona o Parničnom Postupku stranke su dužne da iznesu sve činjenice koje potkrepljuju njihove tvrdnje i da predlaže dokaze kojima se takve činjenice utvrđuju. Drugim rečima svako ko nešto kaže mora to da dokaže (ie incumbit probatio que dicit).

U ovom slučaju, sud nalazi da nije sporna činjenica da je bila radnik DP-a, ali iz dokumentacije sud zaključuje da žalilja nije pružila nijedan relevantan dokaz koji dokazuje da je DP dugovala traženu zaradu za period za koji je podnet zahtev, dokaz da je pružala usluge rada za navedeni period, žalilja nije priložila dokaze u vezi obračuna traženih zarada. Žalilja nije dostavila nikakve dokaze ni nakon što je dobila odbranu tužene. Radna knjižica koju je žalilja dostavila kao dokaz samo dokazuje činjenicu nastanka radnog odnosa, ali ne dokazuje činjenicu nastavka ovog radnog odnosa.Sud nalazi da su u nedostatku dokaza navodi žalilje u vezi naknade za neisplaćene zarade nisu dokazani potrebnim materijalnim dokazima, pa se kao takvi odbacuju kao neosnovani.

Stoga, u skladu sa gorenavedenim i u skladu sa članovima 54.1 i 74.4 Zakona o Posebnoj Komori, odlučeno je kao u izreci presude.

Sudske takse

U skladu sa članom 62.5 Zakona o Specialnoj Komori svaka stranka snosi ce svoje troskove
Žalilja je platila sudsku taksu za podnetu žalbu .

Pravni savet

Protiv ove presude može se izjaviti pismena žalba Žalbenom veću Posebne komore u roku od
15 dana od prijema ove presude. Žalba se mora podneti na osnovu člana 9.6. Zakona o
Posebnoj komori.

Diellza Hoxha Sudija